



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Kabineti i Ministrisë së Drejtësisë – Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 26 /2020
Datë: 13/03 2020

Në mbështetje të Nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore të Agjencive të Pavarura (gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019) si dhe duke u bazuar në Nenin 8 (paragrafi 1.4) të Rregullores nr. 05/2020 për Fushat dhe Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Udhëzimit Administrativ nr.03/2008 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

Për

Lejimin e përdorimit të automjetit zyrtar

1. Z. Qemajl Marmullakaj, Sekretar i Përgjithshëm, në Ministrinë e Drejtësisë, për shkak të specifikave të posaçme të punës, ndërlikueshmërisë, ngarkesës në punë e sipas nevojës edhe punë jashtë orarit të rregullt të punës, i **Lejohet** të ketë në dispozicion dhe përdorim ekskluzivisht zyrtar 24 orë një veturë zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Vetura zyrtare do të përdoret në pajtim me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje.
3. Obligohet shfrytëzuesi i veturës zyrtare sipas këtij vendimi të plotësojë aneksin 03/1 (fletë udhëtimin përkatës për automjete zyrtar) dhe eventualisht në rast të aksidenteve aneksin 6 dhe 7.
4. Specifikat e veturës zyrtare të lejuar në pikën 1 këtij vendimi i cakton sektori i transportit në Ministrinë e Drejtësisë.
5. Obligohet Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.



Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

Vendimi i'u dërgohet:

- Z. Qemajl Marmullakaj;
- Kabinetit të Ministres;
- DFSHP;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.